

#INNO4EDU

Titulli i aktivitetit

Baktere

Mosha

Periudha zhvillimore (nga 5 deri në 10 vjet)

Vendi / lokacioni

Kushte shtëpie

Vlera e karakterit

Fokusim

Koha e nevojshme për përgatitje

10 minuta

Koha e nevojshme për realizim

20-25 minuta

Qëllimet

Qëllimi është që tek fëmija të zhvillohet vetëdija për rëndësinë e shëndetit dhe të aftësohet t'i diktojë faktorët që mund ta rezikojnë shëndetin.

Rezultate të pritshme

Kahje

Përgatitje paraprake për aktivitet

Përgatitje të materialeve dhe ngjyrave për lojë. Një enë qelqi mbushet përgjysmë me ujë. Në një pjatë vihen guralecë ose gjësende të imta, të cilat mund të fundosen në ujë, ndërsa në një pjatë tjetër bëhen toptha pambuku (me koklavitje dhe lëvizje rrethore të duarve dhe gishtave).

Instrukcione / kahje për lojën

Në enën e qelqtë vihen guralecët dhe topthat e pambukut. Fëmija duhet të vërë 2 – 3 pika nga xheli për dezinfektim / sapun dhe me ndihmën e lugës duhet t'i nxjerrë topthat e pambukut nga ena me ujë dhe t'i vendosë në tjetër pjatë.



Aktivitet / lojë

Fëmijës i shpjegohet se guralecët paraqesin vitamina, të cilat duhet çdo ditë t'i marrim përmes pemëve dhe perimeve, e prandaj ato mbeten në trupin tonë (ena e qelqtë me ujë). Meqë çdo ditë luajmë dhe prekim sende të ndryshme, trupi ynë bie në kontakt me baktere të cilat gjenden në trupin tonë (topthat e pambukut) dhe të njëjtat mund negativisht të ndikojnë në shëndetin tonë. Prandaj është shumë me rëndësi të kemi kujdes për higjienën e të përdorim sapun / xhel për dezinfektim.

Fëmija duhet të vërë 2 – 3 pika në enën me ujë e pastaj me anë të lugës t' nxjerrë pambukët – bakteret nga ena. Gjatë lojës bisedohet me fëmijën për mënyrën se si e mbajmë higjienën personale dhe se si duhet të mbrohemi.

Pastaj fëmijës i jepet një fletë letre të ndarë në dy pjesë. Në anën e majtë ai duhet të vizatojë një fëmijë të ndotur, kurse në të djathtënj një fëmijë të pastër dhe pajisje për higjienë personale.

Shtojca	Materiale
----------------	------------------

<p><u>Shtojca nr. 1</u></p> <p>Vegza deri tek filmi i animuar</p> <p>https://www.youtube.com/ëatch?v=uMbcZfb5k3M</p>
--

<p>Enë qelqi; ujë; lugë; pambuk; guralecë ose gjësende të imta që mund të fundosen; 3 enë; xhel për dezinfektim / sapun; fletë letre; ngjyra</p>
--

Aktiviteti është përgatitur nga edukatorët:

Krijuar nga: Sonja Çallovska, Vesna Peceva

Dizajni grafik: Katerina Nikolovska

